MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në **MASH** me objekt: "*Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik dhe financiar për periudhën 1/4/2010 deri 30/9/2011"* dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 47, datë 05/4/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 377/6, datë 05/4/2012 dërguar ***Z. Myqerem Tafaj, Ministër i Arsimit dhe Shkencës,*** krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Nga kontrolli i kryer për ligjshmërinë e shpërndarjes së fondeve të planifikuara për kompensimin e çmimit të teksteve të arsimit parauniversitar dhe arsimit universitar në formën e "transfertës tek individët" në disa Drejtori dhe Zyra Arsimore Rajonale (DAR/ZAR), rezultuan një sërë shkeljesh dhe mangësish, në drejtim të shpërndarjes së fondeve individëve përfitues nga ana e Filaleve të Postës Shqiptare në rrethe.
Sa me sipër argumentojmë se:
Në Filialet e Postave në rrethe nga ana e punonjësve të postave, pagesa e transfertës individëve kryhej kundrejt vendosjes së referencave; emër, mbiemër, firmë ose vetëm firmë pa emër mbiemër, ndërkohë që formulari ka të detyrueshme edhe vendosjen në listëpagesë të numrit të dokumentit të identifikimit të personit përfitues.
Një mënyrë e tillë operimi mbart në vetvete rrezikun e përvetësimit të shumave monetare, nga persona të tjerë që nuk janë përfituesit ligjorë, duke cënuar në këtë mënyrë realizimin e objektivave të Qeverisë, që synojnë mbështetjen buxhetore të kategorive përfituese, të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim.
Po kështu, u konstatua që në Udhëzimin të Përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, dalë në zbatim të VKM nr.107 datë 10/2/2010, pika 9, ku sanksionohet kalimi i dokumentacionit dhe fondeve tek bankat e nivelit të dytë apo tek Filialet e Postës Shqiptare, mungon përcaktimi detyrues që "marrëdhënia midis këtyre subjekteve të rregullohet nëpërmjet një Aktmarrëveshje" .

Nga ana tjetër rezultoi që, në akt-marrëveshjet ekzistuese, mungon përcaktimi që Filalet e Postave të rretheve, të dërgojnë Aktrakordimet për gjëndjen faktike të përdorimit të fondeve buxhetore "Transfertë tek individët" në Drejtorinë e Përgjithshme të Postave, ndërkohë që një linjë e tillë raportimi është sanksionuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
Sa më sipër, **rekomandoj që:**
- Në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, dalë në zbatim të VKM nr.107 datë 10/2/2010 "Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar dhe universitar" dhe Aktmarreveshjet e lidhura midis MASH (DAR/ZAR) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Postës Shqiptare (Filiale apo Zyra Postare) të kryhen përmirësimet në drejtimet e mëposhtme:
a) Në Udhëzimin e përbashkët të përcaktohet që, marrëdhënia midis palëve rregullohet nëpërmjet një Aktmarrëveshje në të cilën përcaktohen procedurat e operimit për transferimin e fondeve të planifikuara për rimbursimin e teksteve të arsimit parauniversitar dhe arsimit universitar .
b) Të sanksionohet në Aktmarrëveshje që, transferimi i fondeve në favor të individeve të kryhet, kundrejt paraqitjes së dokumentit të identifikimit dhe vendosjes së referencave në formularët e shpërndarjes së transfertës.
c) Të vendoset detyrimi i ndërsjelltë që Drejtoria e Përgjithshme e Postës Shqiptare, të ndërmarrë procedura investigimi sa herë që nga auditimet e kryera nga MASH, rezultojnë raste abuzimi në shpërndarjen e fondeve.
d) Të vendoset detyrimi që krahas rakordimeve me bazë rrethi, midis MASH dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Postës Shqiptare të kryhet rakordimi i fondeve faktike (tregues i konsoliduar) që MASH ka transferuar tek individët për vitin korent buxhetor.

Menjëherë

A. <u>MASA ORGANIZATIVE</u>

1. Nga strukturat përgjegjëse të MASH, të merren masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga kontrolli i mëparshëm, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 252/2, datë 6/9/2010, por që nga verifikimi i kryer kanë rezultuar të pazbatuara apo të zbatuara pjesërisht.

Menjëherë

2. Marrë shkas nga shkeljet e konstatuara në transferimin e fondeve tek individët në drejtim të shpërndarjes së fondeve buxhetore për periudhën 2010-2011, fonde këto me destinacion "kompensim transfertë tek individi", për librin shkollor dhe

transportin e mësuesve dhe nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit të tyre, **rekomandoj që:**

a) Ministria e Arsimit dhe Shkencës t'i kërkojë në mënyrë institucionale Drejtorisë së Përgjithshme të Postës Shqiptare, të caktojë si prioritet të saj dhe të kryejë mbikëqyrjen, auditimin dhe investigimin e këtij procesi, për vënien përpara përgjegjësisë të personave që me veprimet apo mosveprimet e tyre i hapin rrugë abuzimit dhe shkeljeve në këtë sektor, i cili konsiderohet me risk të lartë.

b) Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MASH, të përfshijë në planet tremujore e vjetore, auditimin e hollësishëm të përdorimit të këtyre fondeve buxhetore, që nga konstatimi (kërkesat), deri në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të përcaktuara në aktmarrëveshjet e lidhura midis Drejtorive dhe Zyrave Arsimore Rajonale dhe Filialeve të Postave, me shtrirje në të gjithë vendin dhe të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Postës në rastet e konstatimit të abuzimeve në shpërndarjen e fondeve, me synim investigimin e mëtejshëm te tyre.

Menjëherë

3. Të merren masa që në zbatim të VKM nr 107, datë 10/2/2010 "Për procedurat e përdorimit të subvencionit nga buxheti i shtetit për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve të arsimit parauniversitar dhe universitar" dhe udhëzimeve të dala në zbatim të tij, të përfshihen dhe të përcaktohen qartë, në rregulloret e brendshme të Drejtorive dhe Zyrave Arsimore Rajonale, detyrat e punonjësve që merren me pranimin, përpunimin dhe qarkullimin e dokumentacionit të subvencionit, deri në mbërritjen tek përfituesi.

Afati 30 Prill 2012

4. Nga Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës dhe Zyra Arsimore Tepelenë, të kryhen aktrakordimet mujore me Zyrat e Postave respektive dhe të reklamohen në mënyrë institucionale, pagesat e kryera në kundërshtim me ligjin, përfitimet e padrejta, si dhe mospërmbushjet e detyrimeve kontraktuale të shprehura në aktmarrëveshjet e lidhura për këtë qëllim.

Afati 30 Prill 2012

5. Nisur nga konstatimi se në organikën e MASH, 13 punonjës janë marrë në punë me Urdhër të Brendshëm të Ministrit "Për emërim të përkohshëm në detyrë" ku cilësohet se: "*emërohet përkohësisht në punë deri në përfundim të procedurave të rekrutimit*", si dhe referuar faktit që për një kohë relativisht të gjatë ky proces ka mbetur i ngrirë, **rekomandoj që,** të merren masat që në zbatim të ligjit nr. 8549, datë 11/11/1999 "Për statusin e nëpunësit civil", nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Koordinimit Rajonal, të kërkohet zyrtarisht nga Departamenti i

Administratës Publike, përfundimi i shpejtë i procedurave dhe emërimi i tyre si nëpunës civilë në periudhë prove, konform nenit 13 të këtij ligji, si dhe respektimi i afateve për periudhën e provës, konform nenit 14 të po këtij ligji, për punonjësit e tjerë që gëzojnë këtë status.

Menjëherë

6. Referuar faktit që për periudhën objekt kontrolli, nga 26 pozicionet për të cilat ka pasur largime nga puna dhe emërime të reja, 7 punonjës e kanë quajtur të padrejtë largimin nga puna dhe kanë ngritur padi civile në Gjykatën e Shkallës së Parë të rrethit Tiranë dhe meqenëse procesi i gjykimit vazhdon, **rekomandoj që,** Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Koordinimit Rajonal në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimeve Juridike në MASH, në zbatim të VKM nr. 355, datë 2/6/1998 "Procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit" dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të shtetit" në vitet respektive, të realizojë ndjekjen dhe përfaqësimin me korrektesë dhe profesionalizëm, në të gjitha shkallët e gjyqësorit në mbrojtje të interesave të institucionit dhe në çdo rast të mbajnë përgjegjësi për rezultatin e tyre.
Për të gjitha Vendimet Gjyqësore që sjellin dëm efektiv për buxhetin e shtetit, MASH të proçedojë duke nxjerre përgjegjësitë administrative dhe shpërblimin e dëmit financiar shkaktuar buxhetit të shtetit nga personat shkaktarë përgjegjës.

Vazhdimisht

7. Të merren masat për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjitha dokumentet personale për çdo punonjës, përfshirë këtu edhe vlerësimet vjetore, të cilat në momentin e kontrollit ndodheshin në dosje të përbashkët për gjithë administratën.

Afati 30 Prill 2012

8. Me përfundimin e auditimit dhe evadimit të materialeve të auditimit, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për të arkivuar dosjet e auditimit në arkivin e institucionit në përputhje me dispozitat ligjore.

Vazhdimisht

9. Nga shqyrtimi i detajimeve të grantit konkurrues për arsimin bazë, bazuar në vendimin e Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve, rezulton se, është kryer alokimi i fondeve të projekteve të investimeve në mënyrë pjesore dhe jo në vlerën e plotë të objektit edhe kur vlera e plotë e projekteve është e realizueshme brenda vitit buxhetor. Një mënyrë e tillë financimi, sjell zgjatjen e afatit të përfundimit të objekteve në më shumë se një vit buxhetor, dhe nga ana tjetër, kjo shoqërohet me rritjen e detyrimeve të shtetit ndaj kontraktorëve me të cilët kontrata është lidhur

për vlerën e plotë të objektit, por që për vitin korent akordimi i fondit kryhet i pjesshëm. Argumentojmë që për vitin 2011 u konstatuan 29 raste projektesh, vlera e plotë e të cilëve varion nga 3 deri në 10 milionë lekë dhe fondet e alokuara për çdo projekt për vitin korent, rezultuan në rreth 30-40% të vlerës së plotë.
Sa më sipër**, rekomandoj që,** MASH në bashkëpunim me Komitetin e Zhvillimit të Rajoneve, me Sekretariatin e Përgjithshëm të këtij komiteti, të marrin masa për shpërndarjen e fondeve të investimeve të grantit konkurues për arsimin bazë, duke synuar financimin e projekteve në vlerën e plotë të projektit, kur vlera e tyre është e realizueshme brenda vitit buxhetor, sikurse janë vlerat e kopshteve, shkollave me numër nxënësish relativisht të vogël etj.

Vazhdimisht

10. Marrë shkas nga konstatimi që për rikonstruksionin e shkollave ekzistuese dhe për ndërtimin e shkollave të reja nuk janë zbatuar standarde të njëjta projektimi që lidhen me masat e sigurisë dhe mbrojtjes së objekteve nga shkarkimet atmosferike etj., **rekomandoj që:**
Të ngrihet një grup pune nga MASH në bashkëpunim me Drejtoritë dhe Zyrat Rajonale Arsimore për evidentimin e të gjithë objekteve ekzistuese dhe të përcaktohen detyra konkrete për masat që duhen marrë për sigurimin e objekteve me sistemin e rrufepritësave**.**

Menjëherë

11. Nga verifikimi i zbatimit të projekteve të shkollave në terren, në disa raste u konstatua se dyert e brendshme të klasave nuk mundësonin shikueshmërinë brenda ambientit mësimor, si dhe u konstatuan mungesa të objekteve për mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike etj.
Për këtë, **rekomandoj që:**
Njësive të qeverisjes vendore, përfituese të fondit të zhvillimit të rajoneve, t'u kërkohet që, në detyrën e projektimit të vendoset standardi sipas të cilit, dyert e brendshme të klasave te projektohen me dritare të vogla prej xhami të tejdukshëm, për vrojtimin nga koridori të zhvillimit të mësimdhënies, si dhe standardi i parashikimit të mbrojtjes së objekteve nga shkarkimet atmosferike.

Menjëherë

12. Me synim eliminimin e rasteve të financimit të projekteve ndërtimore të shkollave të cilat janë të pa azhornuara me terrenin, **rekomandoj që,** t'u kërkohet Njësive të Qeverisjes Vendore që me paraqitjen e projekteve për aplikim nga ana e investitorit, të konfirmohet që projekti është azhornar me terrenin. Ky konfirmim duhet të jetë i bazuar në një Procesverbal të hartuar midis projektuesit dhe investitorit për studimin e relievit të sheshit të ndërtimit.

Menjëherë

13. Nga ana e Sekretariatit Teknik të Ministrisë i ngarkuar me vlerësimin teknико-ekonomik të projekteve të financuara me fondin për zhvillimin e rajoneve, në kriteret e vendosura për vlerësimin teknik të projekteve, të vendosen edhe plotësimi i kritereve të parashikuara në rekomandimet 11 dhe 12 trajtuar sa më sipër.

Menjëherë

14. Me qëllim rritjen e përgjegjësisë së punës projektuese dhe preventivuese, si dhe duke marrë shkas nga ndryshimet e volumeve në shtesë apo pakësim që bëhen në përgjithësi nga mbikëqyrësi i punimeve pa dijeninë e projektuesit, si dhe ruajtjen e të drejtës së autorit, **rekomandoj që,** në të gjitha rastet e kontraktimit me projektuesin të parashikohet mbajtja e garancisë 5% e tarifës së parashikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 444, datë 6/9/1994 "Për tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit".

Menjëherë

15. Marrë shkas nga mangësitë e konstatuara për cilësinë e zbatimit të projekteve, MASH si institucioni akordues e monitorues i fondeve për zhvillimin e rajoneve në bashkëpunim me Komunat e poshtëcituara në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve, të koordinojnë veprimet për marrjen e masave për kryerjen e punimeve nga ana e operatorëve ekonomikë, *pasi defektet janë krijuar brenda periudhës së garancisë*, prandaj në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi, të ligjit nr. 8402 datë 10/9/1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" sipas të cilit shpenzimet për riparimin e difekteve do të kryhen nga sipërmarësit e punimeve dhe konkretisht:

a) Për objektin "Rikonstruksioni i shkollës 9/vjeçare në Komunën e Vërtopit, të riparohen *defektet e suvatimeve* të mureve dhe tavaneve të kryera me cilësi të dobët dhe të eliminohet *prezenca e lagështirës* në katin përdhe të shkollës dhe në teracën e katit të dytë, si dhe të kryhen punimet për *mbrojtjen atmosferike* të shkollës.

b) Për objektin "Rikonstruksionin e shkollës 9/vjeçare" në Komunën Bishan, të eliminohen cilësia e dobët e punimeve të konstatuara në lyerjen me bojë vaji të sipërfaqeve të patinuara në muret e korridoreve.

c) Për objektin "Rikonstruksioni i Shkollës së Mesme të Bashkuar" në Komunen Çërravë, të krijohet grup pune, me përfaqësim nga Komuna Çërravë, nga sipërmarrësi i punimeve, mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve, për të përcaktuar masat tekniko-organizative për eliminimin e lagështirës në katin e sipërm të shkollës.

d) Për objektin "Ndërtim shkolla 9/ vjeçare" Komuna Fierzë, të ngrihet grup teknik me përfaqësim nga komuna dhe mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve në bashkëpunim me projektuesin, të verifikojnë me përgjegjësi, shkakun për defektet e shfaqura në soletën e klasës në pjesën veri-perëndimore të shkollës, të konkludojnë me një akt teknik dhe të marrin masa për riparimin e gjendjes. Po kështu, nga sipërmarrësi i punimeve të vendosen dërrasat mbrojtëse të lyera me llak në klasat e shkollës, si dhe të ribëhet lyerja e shkollës me bojë plastiko.
e) Për objektin "Rikonstruksion shkolla 9/vjeçare Rrapëz" të kryhen punimet për instalimin e dy hidrantëve zjarrfikëse dhe ndërtimin e kornizës së betonit për murin rrethues me vlerë 11,090 lekë me t.v.sh.
f) Për objektin "Rikonstruksion i kopshtit Kolonjë", mbikëqyrësi i punimeve në bashkepunim me projektuesin dhe investitorin, të studiojnë me përgjegjësi dhe t'i japin zgjidhje spostimit të linjës elektrike 380 V, që kalon përsipër kopshtit dhe meqenëse objekti ishte i papërfunduar për efekt të alokimit të fondeve nga MASH, në vitin 2012 të kryhen punimet për patinimin e mureve të korridorit dhe suvatimin e mureve në vlerën 79,392 leke me t.v.sh.
g) Për objektin "Shtesë godine Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit të Universitetit Bujqësor të Tiranës" enti kontraktues (UBT), duhet të gjejë zgjidhjen dhe të kërkojë alokimin e fondeve për vendosjen e dy ashensorëve për studentet paratetraplegjike. Mbikëqyrësi i punimeve, investitori dhe sipërmarësi i punimeve të rakordojne volumet e preventivuara në shtesën e projektit që është bërë për katin bodrum. Në funksion të këtij rakordimi, të akordohet fondi për shtesën e sipërfaqes së shfrytëzueshme të objektit.

Menjëherë

C. <u>MASA PËR SHPËRBLIM DËMI</u>

1. Nga MASH, në cilësinë e institucionit akordues dhe monitorues të fondit të zhvillimit të rajoneve, t'i kërkohet Njësive të Qeverisjes Vendore që të marrin masa dhe të ndjekin procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët e gjykimit, për t'i kërkuar 8 subjekteve përkatëse shpërblimin e dëmit **në vlerën 518,908 lekë.**

Menjëherë

2. Nga Universiteti Bujqësor Tiranë, për objektin "Rikonstruksioni dhe shtesë kati në godinën e Laboratorit të Kimisë", në cilësinë e investitorit të merren masa dhe të ndiqen procedurat në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për t'i kërkuar subjektit [redacted] sh.p.k., shpërblimin e dëmit **në vlerën 147,271 lekë,** si dhe shpërblimin e dëmit subjektit fizik në cilësinë e mbikëqyrësit [redacted] **në vlerën 271,583 lekë**.

Menjëherë

D. <u>MASA DISIPLINORE</u>

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12/7/1995 "Kodi i punës në RSH", ndryshuar me ligjin nr. 9125, datë 29/7/2003, ***i kërkohet Titullarit të MASH,*** *të japë masën disiplinore*:

"Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna", për:

1. [redacted] ***në pozicionin Drejtor i Drejtorisë Arsimore Rajonale Berat,*** për mos ushtrim të detyrës funksionale si Titullar i Autoritetit Kontraktor, duke mos ngritur komisionin e llogaritjes së fondit limit për transportin e mësuesve dhe nxënësve, i cili ka sjellë për pasojë llogaritjen e fondit jo sipas kritereve të VKM-së nr. 66, datë 7/2/2007 "Tarifat e transportit rrugor ndërqytetas të udhëtarëve me autobus".

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12/7/1995 "Kodi i punës në RSH", ndryshuar me ligjin nr. 9125, datë 29/7/2003, ***i kërkohet Titullarit të Drejtorisë Arsimore Rajonale Durrës****, të japë masën disiplinore:*

"Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna", për:

1. [redacted] ***në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Financës, në Drejtorinë e Drejtorisë Arsimore Rajonale Durrës,*** për mbajtjen e aktrakordimit të datës 19/8/2011, midis Drejtorisë Rajonale Arsimore dhe Filialit të Postës Durrës dhe pranimin si pjesë e këtij aktrakordimi të listë pagesave me mangësi dhe shkelje në mënyrën e plotësimit të tyre, në kundërshtim me kriteret e kryerjes se pagesave kundrejt vendosjes së referencave; emër, mbiemër, firmë ose vetëm firmë pa emër mbiemër, ndërkohë që formulari e ka të detyrueshme edhe vendosjen në listëpagesë të numrit të dokumentit të identifikimit të personit përfitues, duke lënë shteg në këtë mënyrë për kryerjen e veprimeve abuzimeve .

Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12/7/1995 "Kodi i punës në RSH", ndryshuar me ligjin nr. 9125, datë 29/7/2003, ***i kërkohet Titullarit të Zyrës Arsimore Tepelenë,*** *të japë masën disiplinore:*

"Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna", për:

1. [redacted] ***në cilësinë e përgjegjëses së Degës së Shërbimeve të Zyrës Arsimore Tepelenë,*** për mbajtjen e aktrakordimit të datës 31/3/2011, midis Zyrës Arsimore dhe Filialit të Postës Tepelenë dhe pranimin si pjesë e këtij aktrakordimi të listëpagesave me mangësi dhe shkelje në mënyrën e plotësimit të tyre, në kundërshtim me kriteret dhe kryerjes se pagesave kundrejt vendosjes së

referencave; emër, mbiemër, firmë ose vetëm firmë pa emër mbiemër, ndërkohë që formulari e ka të detyrueshme edhe vendosjen në listëpagesë të numrit të dokumentit të identifikimit të personit përfitues, duke lënë shteg në këtë mënyrë për kryerjen e veprimeve abuzimeve.

Shënim: Auditimi u krye nga Kryeauditueshja Luljeta Nano Përgjegjëse Grupi dhe audituesit Monika Dushku, Vasil Vane, Ludmilla Sulaj dhe Mina Blushi. Më tej u shqyrtua nga Drejtori i Departamentit z. Ded Trieshi dhe Drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë zj. Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT